



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 20/2010

Prishtinë më 11. 05. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Nerxhivane Dauti, Fatmir Rexhepi, Zef Morina dhe Mufëra Şinik.

Munguan: Mursel Halilji, Qamile Morina dhe Kaqusha Jashari.

Pjesëmarrës të tjerë: Osman Ejupi - kryetar, Ahmet Krasniqi - KKK, Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Besim Zeqiri – ICO dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale;
4. Të ndryshme;

***Kryetarja** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me sqarimin se procesverbali i mbledhjes së fundit shtyhet për mbledhjen e radhës, ngase njësia mbështetëse për shkaqe objektive nuk kishte arritur ta përgatiste.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2009

Raporti i KKK-së u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve dhe është konfirmuar pjesëmarrja e përfaqësuesve që janë këtu. Fjala iu dha kryetarit të KKK-së, z. Osmani, që ta paraqiste një raport të përgjithshëm për punën e KKK gjatë vitit 2009.

Osman Ejupi - Tha se aktiviteti i Komisionit gjatë vitit 2009 ka qenë si vijon: e kemi bërë një memorandum të mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës së Shqipërisë; një memorandum me Autoritetin e Konkurrencës së Maqedonisë; i kemi ngritur kapacitetet, d.m.th. kemi arritur t'i punësojmë edhe 6 anëtarë të tjerë; jemi anëtarësuar në Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës, si shteti i 107-të me të drejta të barabarta; jemi anëtarësuar si anëtar me të drejta të barabarta në Qendrën Rajonale të Trajnimeve të Konkurrencës me seli në Budapest; kemi arritur të kemi një vizitë studimore me karakter të konkurrencës, përkrahur nga TAIEX-i në Romë, në Autoritetin e Konkurrencës së Italisë; kemi vizituar disa autoritete me karakter ndërkombëtar, siç është ai i Zvicrës me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konkurrencës së Evropës; me rastin e Ditës Evropiane të Konkurrencës në Kosovë për Konkurrencë, i kemi thirrur të gjitha autoritetet institucionale edhe të komuniteteve të bizneseve për konkurrencën dhe për mbrojtjen e konkurrencës dhe i kemi bërë disa aktivitete të tjera, që kanë të bëjnë me vizita studimore nëpër seminare, duke filluar nga Maqedonia, Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Çekia, Hungaria e Italia deri në Sllovaki. Këto ishin disa aktivitete që ne kemi arritur t'i bëjmë gjatë këtij viti. Gjatë këtyre muajve kemi marrë gjithsej 4 vendime. E para ka të bëjë me Shoqatën e Furrarëve, e cila është një marrëveshje, që e kemi quajtur të paligjshme, në bazë të nenit 3, pika 3 e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, që ka të bëjë me fiksimin e çmimeve dhe me fiksimin e gramaturës së bukës, d.m.th. të peshës së bukës. Këtë rast e kemi analizuar ne, anëtarët e Komisionit, sepse nuk kemi pasur staf që ta shqyrtonte. I kemi kryer të gjitha procedurat që parashihen në bazë të Ligjit për Konkurrencën, pra i kemi ftuar palët në një seancë dëgjimore. E kemi gjetur marrëveshjen e nënshkruar nga anëtarët e Shoqatës së Furrarëve të Kosovës, e kemi analizuar ligjin dhe kemi ardhur në përfundim se marrëveshja nuk është e ligjshme dhe në fund kemi marrë vendim për shfuqizimin e saj. Marrëveshja është shfuqizuar edhe me vullnetin e furrarëve, për arsye se ata nuk kanë qenë në dijeni se ekziston Ligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe nuk kanë qenë të vetëdijshëm se e kanë shkelur konkurrencën. Kështu rasti i parë ka kaluar pa dënime, por me mirëkuptim dhe me shfuqizimin e marrëveshjes. Rastin e dytë, e kemi filluar hetimin mbi themelimin e një marrëveshje të ashtuquajtur "PULL" ndërmjet shoqatave të sigurimit të Kosovës ose kompanive të sigurimit të Kosovës. Këtë rast, i cili na ka rënë në dorë, e kemi hetuar.

Komisioni në tri raste mund të fillojë procedurën: kur dikush e inicion ose kërkon nga Komisioni ta hetojë një rast, kur Komisioni e konsideron se është e nevojshme dhe ka parametra se diçka po ndodhë në treg. Këtë rast e kemi hetuar, meqë na ka rënë në dorë një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet kompanive të sigurimit, të cilat, me atë marrëveshje, e kanë fiksuar çmimin e policave kufitare. Pra është një produkt i sigurimit, që quhet policë kufitare dhe shitet për të gjithë bashkatdhetarët, të cilët hyjnë në territorin e Kosovës, me fiksimin e çmimit prej 70 eurove dhe nëpërmjet të një kompanie sigurimesh. Janë mbledhur të gjitha dhënat, është ndarë tregu dhe është bërë marrëveshja, që në të gjitha pikat e hyrjes kufitare në Kosovë të vendoset e njëjta policë kufitare, i njëjti çmim, nga një përfaqësues i një kompanie të sigurimeve. Këtë marrëveshje e kemi analizuar dhe në bazë të Ligjit kemi konstatuar se ishte në kundërshtim me nenin 26, pika 6 e Ligjit për Konkurrencën. E kemi kërkuar burimin se në bazë të cilit ligj ose në bazë të të cilave rregulla ishte hartuar kjo marrëveshje. Erdhëm në përfundim se Banka Qendrore e Kosovës, në bazë të pikës 3, u ka dhënë mundës shoqatave të sigurimeve ta bëjnë këtë marrëveshje. E kemi shqyrtuar edhe pikën 3 të rregullës 3 dhe e kemi mbajtur një seancë bashkëpunimi ose konsultimi edhe me autoritetet e Bankës Qendrore të Kosovës, në të cilën kemi ardhur në përfundim se së pari duhej të shfuqizohej rregulla 3, që është bazë për hartimin e kësaj marrëveshjeje dhe pastaj të kalohej te marrëveshja. Pas dy seancave, që i kemi zhvilluar me autoritetet e Bankës Qendrore të Kosovës, së fundi edhe me guvernatorin, kemi marrë një vendim, i cili i shfuqizon pikën 3 dhe rregullën 3 për themelimin e marrëveshjes së quajtur “PULL”, ose të marrëveshjes ndërmjet kompanive të sigurimit. Ky ka qenë vendimi i dytë. Vendimi i tretë është marrë kur e kemi shqyrtuar edhe çështjen e policave kufitare, që janë shitur anekënd Kosovës. Kemi ardhur në përfundim se edhe këto polica duhet të shfuqizoheshin në bazë të ligjit, edhe pse Kosova, në kuptimin formal, ende nuk është anëtare e “Kartonit jeshil” dhe se qytetarët tanë që hyjnë në territorin e Kosovës, sipas profesionistëve të Bankës Qendrore dhe të kompanive të sigurimit, duhet të mbrohen me nga një policë mbrojtëse me rastin e hyrjes në territorin e Kosovës. Pas disa konsultimeve, që i kemi pasur edhe me ndërkombëtarët dhe me autoritetet e tjera homologe në rajon, si me të Shqipërisë, të Kroacisë, na është sugjeruar se rast identik me këto polica kufitare ka pasur edhe në Shqipëri, edhe në Kroaci. Edhe ata këto polica i kanë konsideruar joligjore, i kanë shfuqizuar dhe i kanë hequr nga tregu. Ne e kemi marrë vendimin e tretë, në fakt rekomandimin e tretë dhe u kemi sugjeruar Bankës dhe kompanive të sigurimit ta shfuqizojnë marrëveshjen e “PULL”-it dhe ta gjejnë një zgjidhje kalimtare, derisa Kosova të futet në Unionin e “Kartonit jeshil” të Komunikacionit. Vendimi i katërt ka të bëjë me Ministrinë e Telekomunikacionit, përkatësisht me Udhëzimin administrativ nr. 2008/13, i cili sipas nesh, ka të bëjë me shkeljet ligjore që kanë të bëjnë me nenin, 3 paragrafi 2, ku Ministria në mënyrë decitive udhëzon që të gjithë pronarët e automjeteve t’i regjistrojnë e t’i kontrollojnë automjetet e tyre në vendin ku janë banorë. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për konkurrencën, sepse së pari bëhet ndarja e tregut. Mbi këtë bazë e kemi shfuqizuar atë dhe i kemi rekomanduar Ministrisë ta shfuqizojë këtë Udhëzim administrativ dhe të hartojë udhëzim në përputhje me rregullat e tjera ligjore dhe në përputhje me Ligjin për Konkurrencën, ku ndarja e tregut është jo e pranueshme. Qytetarët kanë të drejtë që kontrollin teknik ta kryejnë aty ku mendojnë se është më mirë. Natyrisht ata dëshirojnë ta bëjnë aty ku është më lirë. Me këtë Udhëzim administrativ në njëfarë forme MTT-ja e ka bërë ndarjen e tregut dhe e ka bërë fiksimin e çmimeve. Këto

ishin vendimet që i kemi marrë në këtë vit. Për kureshtjen tuaj ju them se, në bazë të Ligjit për konkurrencën, hetimet tona duhet të zgjasin së paku 3 muaj e deri 2 vjet. Kjo ndodh, sepse ne njëkohësisht e luajmë rolin e një inspektimi, pastaj i marrim argumentet, i analizojmë dhe e marrim vendimin, i cili nuk e ka formën e prerë, por ekzekutive. Në bazë të kësaj, për këto 4 hetime, na është dashur së paku kjo periudhë 11 - 12 mujore. Kjo ka të bëjë me progresin, për të cilin, pak a shumë, jemi përpjekur që me këta pesë anëtarë të Komisionit të punojmë gjatë vitit të kaluar. Pjesa e fundit e Raportit, që e kam përfshirë, ka të bëjë me sfidat në të cilat ka hasur Komisioni. E para, është mirë t'ju njoftoj, se sot e kësaj dite, të gjitha këto që i thamë, i kemi bërë me Ahmetin në shtëpi, nëpër kafe dhe nëpër vende të tjera, sepse praktikisht nuk kemi hapësira të punës. Ne e kemi vetëm një zyrë me 11 vetë, që nuk është më e madhe se 3 me 4 dhe të gjitha sendet i kemi grumbull aty. Edhe pse jemi përpjekur të gjejmë zgjidhje më të mirë nuk ia kemi arritur. Iu kemi drejtuar edhe Kryetarit të Kuvendit, edhe Ministrisë për Shërbime Publike, por nuk kemi gjetur ndonjë zgjidhje deri më tash. Pra mungesa e hapësirës së punës, stafi me përvojë të pakët në fushën e konkurrencës, për arsye se konkurrenca është diçka e re edhe për neve edhe për vendet e rajonit, nevoja e përkrahjes nga donatorë të ndryshëm në kuptimin e trajnimeve dhe të hetimeve kanë qenë pengesë. Edhe pse kemi pasur përkrahje nga Zyra Ndërlidhëse e BE-së - TAJEKS-i na ka financuar në një vizite studimore në Romë - megjithatë nuk kemi pasur ndihma të tjera për Komisionin e Konkurrencës sa i përket profesionalizimit ose edukimit për konkurrencën. Mendojmë se, në vazhdimësi, si objektiv duhet të kemi ngritjen e kapaciteteve humane dhe profesionale të autoritetit. Ne i kemi edhe disa raste tani në hetim, siç janë tregu bankar, tregu i telefonisë mobile dhe tregu i energjisë elektrike dhe jemi duke i analizuar në bazë të Ligjit në fuqi. Jemi përqendruar kryesisht kemi kartelat dhe në abuzimet shumta që po ndodhin. Kjo ishte në pika të shkurtra ajo që e ka përfshirë Komisioni në Raportin që e keni përpara.

Kryetarija - I falënderoi përfaqësuesit e KKK-së për arsyetimin e Raportit dhe për paraqitjen e sfidave me të cilat ballafaqohet ky Komision. Fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Zef Morina - Tha se duhet të mbështetet Raporti dhe Komisioni për punën që e kanë bërë. Është një raport, i cili vërtet ka mjaft gjëra për punën e kryer. Shihet se ka pasur vërtet probleme. Problemi kryesor është mungesa e hapësirës. Duhet sa më shpejtë që të jetë e mundur të rregullohet kjo çështje. Përndryshe puna nuk do të ishte e lehtë dhe e efektshme. Unë, duke u bazuar në Ligj, desha të pyes për disa ndërhyrje ose ndryshime të Komisionit. Është fjala për rastin e policave kufitare për automjetet që vijnë nga bota e jashtme ose për automjetet që nuk janë të regjistruara në Kosovë. Pas ndërhyrjes për këtë çështje, si është tani situata? A vlen e njëjta gjë? A duhet të paguajnë të njëjtën sasi të mjeteve për aq ditë sa qëndrojmë këtu dhe në cilën formë? A është ndonjë kompani tjetër apo janë disa kompani që i ofrojnë ato çmime, apo si është puna? Gjithashtu kompanitë e sigurimeve gjatë kontrollimit të automjeteve si veprojnë për ata që dëmtohen totalisht? Si veprohet kur dëmtohen edhe sigurimi i automjeteve, edhe buxheti i Kosovës? A keni ndërhyrë në ndonjë rast të këtillë? Ajo që më shtyu më shumë të përqendrohem është Udhëzimi administrativ 2008/13 i Ministrisë së Transportit, i cili e përcakton kriterin si duhet të bëhet kontrollimi i automjeteve. Mendoj se ai Udhëzim nuk bie ndesh me Ligjin,

përkundrazi i rregullon saktë formën dhe kriteret si duhet të kontrollohen automjetet. Numri i kontroleve teknike, të cilat janë lëshuar në mbarë territorin e Kosovës, janë dhënë në bazë të një kriteri, që është jo vetëm për ne, por për mbarë shtetet e Evropës, për kontrollimin e mirëfilltë teknik të automjeteve dhe mbi bazën e sasisë së automjeteve është lëshuar edhe numri i licencave. Nuk ka asnjë logjikë që, nga një komunë tjetër, për hir të asaj që quhet konkurrencë, të shkojë jo me makinë, por me dokumente për ta regjistruar makinën në një komunë tjetër, për shkak se aty ka njerëz, me të cilët ka raporte ose i njeh dhe vetëm i shkruan letër. Kështu ka ndodhur shumë herë. Pikërisht për këtë arsye Ministria e ka marr një vendim dhe mendoj se është shumë i drejtë që për kontrollimin teknik të automjeteve të caktohet edhe koha, edhe vendi, edhe çmimi. Sot, në shumicën e komunave, kontrollimi nuk bëhet fare dhe pothuajse çdo ditë kemi ndeshje. Pikërisht 50% e tyre ndodhin se nuk bëhet kontrollimi i automjeteve. Këto duhet t'i keni parasysh dhe kërkesën që e keni bërë, ta shqyrtoni edhe njëherë. Unë plotësisht pajtohem, që konkurrenca të jetë e lirë, por nuk jam për konkurrencë jolojale, pra jo konkurrencë e cila do të shkaktohte më shumë dëm se dobi. Sa i përket tregut, qoftë në telekomunikacion, qoftë në energjetikë, qoftë në fusha të tjera, është shumë e vërtetë se kërkojnë të jeni sa më në nivel, të jeni sa më të vendosur që të vihet rregull. Ne jemi duke jetuar këtu dhe e dimë si janë duke shkuar gjërat. Na vjen keq se ndoshta kushtet si keni si duhet, por për këtë, ne si Komision, nëse kemi mundësi, të ndikojmë, qoftë edhe te Kryetari i Kuvendit, që të keni mundësi teknike të veproni. Natyrisht këto gjëra duhet t'i kemi parasysh, sepse duke u përpjekur të rregullojmë diçka, të mos prishim gjëra të tjera. Unë pikërisht po përqendrohem në këto dy çështje, të cilat kanë rëndësi shumë të mëdha.

Fatmir Rexhepi - Vlerësoj se ky Komision e ka një rol të rëndësishëm. Sikurse agjencitë e tjera të pavarura duhet ta kryejë punën si duhet dhe në përputhje me ligjet. Puna njëvjeçare nuk është ndonjë afat i gjatë, në të cilin mund të mbështetemi, sepse mbetet të vazhdojmë me një dinamikë edhe më të madhe të punës. Vlerësoj se anëtarët e këtij Komisioni kanë nevojë të bëjnë vizita (siç u përmendën) që t'i shohin praktikën dhe përvojat e vendeve të tjera, të cilat duhet t'i implementojnë sa më shpejt në fushën e mbrojtjes së konkurrencës edhe në vendin tonë. E dimë të gjithë se nuk ka konkurrencë të ndershme, e cila do krijonte një ambient konkurrent ekonomik me një ndikim të madh në ekonominë e vendit. Edhe për ju do të jetë problem, sikurse edhe për vetë Qeverinë ose për politikat e Qeverisë, të ndërtohet një konkurrencë e shëndoshë në tërë shoqërinë tonë. Ne ju përkrahim në këtë drejtim. Rëndësi ka që ju edhe më tej të hulumtoni ku është monopoli më i madh dhe cili është ndikimi më i madh i sferave të caktuara, qoftë i ndërmarrjeve publike ose i ndërmarrjeve të tjera në vendin tonë, në mënyrë që sa më shpejt të çlirohem prej kësaj dukurie dhe të fillohet një konkurrencë në tregun e punës dhe në ofrimin e shërbimeve të caktuara për qytetarin, që janë në interes të vetë qytetarit, të shoqërisë dhe të ekonomisë sonë. Shtoi se ka qenë një kaos i vërtetë në sektorin e kontrollimeve teknike. Kaos ka edhe në fusha të tjera, që i keni përmendur ju, qoftë në planin e fushës së sigurimit ose të çështjes së bankave, për veprimet që i kanë bërë ose edhe për çështje të tjera, të cilat kanë ndodhur në sektorin e tregtisë e të industrisë e kështu me radhë. Kjo ka rënë në sy, për arsye se ishte krijuar një rrethanë që e dëmtonte qytetarin. Ne jemi dëshmitarë dhe është fakt i pamohueshëm se nuk kontrolloheshin fare automjetet. Nëpërmjet agjencive të sigurimit ose edhe agjencive të tjera, vetëm dorëzohej librezja edhe dukej se bëhej një treg i zi, ku nuk dihej as çmimi, as cilësia dhe nuk

mbrohej asgjë. Mendoj se duhet ta bëni një vlerësim më kritik, sepse konkurrencë ka meqë brenda një komune nuk është vetëm një kompani, që e bën kontrollimin teknik, por janë disa. Kjo është e mirë, sepse nuk ka nevojë të shkojmë për ta regjistruar veturën, p.sh. prej Gjilanit në Pejë. Kjo nuk është konkurrencë dhe nuk përputhet me interpretimin që e përmendët. Nëse diçka është punuar mirë në këtë Ministri, është ky vendim që ka qenë korrekt dhe ka ndihmuar të vërë disiplinë në tregun e kontrollimit dhe ta shtojë cilësinë së kësaj natyre. Kjo ndikon drejtpërsëdrejti në sigurinë, jo vetëm të automjetit, por edhe të njerëzve dhe të rregullit në komunikacion. Pra konkurrencë ka. Pat filluar çmimi të bëhej edhe 5 euro, edhe 2 euro, që nuk është në rregull, sepse paratë e tjerat i vidhnin. Tash, kush ofron cilësi më të mirë, kush ofron shërbim më të mirë, ka mundësi të krijojë konkurrencë brenda atij çmimi, brenda asaj zone që është më korrekte. Raportin e miratoj dhe shpresoj se ju do t'i ngrini edhe më tutje kapacitetet, sepse roli dhe rëndësia e këtij Komisioni, e kësaj Agjencie, në kuadër të Qeverisë, për çështjen e caktuar, për konkurrencën, ka domethënie. Ky është një hap shumë i madh në jetën ekonomike për të gjitha sektorët. Sa më shpejt që t'i kontrolloni, t'i mbikëqyrni, të merrni nisma, vendime, qëndrime të drejta e parimore, aq më shpejt do të ndihmoni në krijimin e konkurrencës. Është një gamë e madhe punësh që ju pret. Për këtë ne ju përkrahim dhe ju mbështesim.

Ethem Çeku - Tha se nuk më pëlqen ideja që pas 10 muajve, menjëherë në hapin e parë, ta bëni ndryshimin e ligjeve, me arsyetimin se nuk mund të implementohen. Kështu, gjatë gjithë kohës, mbetemi në fazën e ridraftimeve të ligjeve. Shpreh brengosje për mungesën e kushteve elementare për punë. Jeni të detyruar që shpeshherë të punoni, siç thatë vetë, edhe në lokale private – kafene. Veprimet ndaj furrtarëve i mbështes dhe vlerësoj se keni bërë mirë, po mua më intereson çka keni bërë me konkurrencën në sistemin bankar – në sistemin e kredive? A keni mundur t'i thoni ProCredit Bankës, Reiffeissen Bankës dhe bankave të tjera: Ju i keni kamatat më të mëdha se çdo bankë dhe çdo vend? Kosova si vendi më i varfër i ka kamatat më të mëdha sesa të gjitha vendet e rajonit. Po t'i shikoni Shqipërinë, Kroacinë, Slloveninë, kamatat janë më të vogla. Edhe Kosova tani është bërë shtet i pavarur dhe më nuk e ka më statusin e rrezikshmërisë aq të madh sa të kemi kamatën vjetore përafërsisht 10 ose 11 %. Në konkurrencë, në qoftë se flasim për konkurrencën botërore, në Kosovë, në këtë vend të vogël, sistemi bankar është sistemi më i ndjeshëm dhe më vital për zhvillimin ekonomik të vendit. Mirë që i vlerësoni edhe faktorët e tjerë, por së pari, sipas meje, duhet të përqendrohemi në çështjet thelbësore. E para, për mua, është që ju të fokusoheni në sistemin bankar, pra në sistemin e kredive. Problemi i dytë janë për ne, që dëshirojmë të aderojmë në BE, ligjet. Infrastruktura ligjore duhet të përafrohet me sistemin e BE-së. Çështja që më brengos pa masë është se zhvendosja e monopolit, monopolit shtetëror po bëhet monopol privat. Shoqëria kosovare, ekonomia kosovare, në disa sektorë të caktuar, po kalojnë nga një monopol shtetëror në një monopol privat, p.sh. në sektori energjetik, gradualisht po rrëshqet në monopol privat.

Sala Berisha – Shala - Bazuar në faktin se është hera e parë që ky institucion i raporton Kuvendit, jemi të vetëdijshëm për vështirësitë e punës suaj prej themelimit e deri më tani, siç janë: ballafaqimi me mungesë të hapësirave të punës, vakumet dhe lëshimet që përmban Ligji. Edhe ne vlerësojmë se Ligji në fjalë duhet të ndryshohet. Mendoj se kjo është paraparë në strategjinë legjislativë të Qeverisë. Ndoshta nuk kemi mundësi ta vlerësojmë edhe aq shumë performancën e këtij institucioni për shkak të kushteve dhe të

rrethanave në të cilat ka punuar. Sidoqoftë, nga kjo që u raportua në formë të shkruar dhe nga paraqitja që u bë nga ana juaj, mendoj se Raporti mund të miratohet dhe të procedohet në Kuvend. Shpresoj se të gjitha pengesat, që i keni pasur gjatë punës suaj, brenda vitit 2009, do të eliminohen së shpejti dhe do të krijohen kushte normale për punë.

Osman Ejupi (KKK) - Falënderoj për vlerësim të Raportit dhe për sugjerime. Jemi përpjekur, si fillestarë, ta bëjmë punën sa më mirë. Ky organ, tani e tutje, do ta ketë një performancë edhe më të mirë, do të marrë më shumë vendime, më të drejta dhe më të shpejta.

Ethem Çeku – I porositi përfaqësuesit e KKK-së që të bëjnë veprime të rëndësishme për ekonominë kosovare, të vënë kontakt me përfaqësues të Komisionit Evropian dhe të USAID-it dhe të kërkojnë prej tyre mbështetje për trajnime, p.sh. në fushën financiare, në sistemin bankar - për të gjitha çështjet që i vlerësojnë, që punët të shkojnë si duhet. Këto institucione mund t'u ndihmojnë shumë.

Ahmet Krasniqi – Tha se arsyeja kryesore, pse jemi të interesuar ta ndryshojmë Ligjin, është se në Kosovë ai shkelet me të madhe dhe nuk respektohet konkurrenca. Dënimet në Kosovë, në krahasim me shtetet e tjera, janë shumë të vogla. Te ne për një kompanie publike ose private dënimi më i lartë është 100.000,00 euro, kurse në Bullgari, p.sh. Reiffeissen-i është dënuar me 4.5 milionë euro.

Myzejene Selmani – kryetare - E përgëzoi KKK-në për punën që e ka bërë dhe që është përfshirë në Raport. Duke e pasur parasysh se keni hapësirë shumë të ngushtë, rekomandojmë të vendoseni në një objekt, ku do të mund ta zhvilloni normalisht punën tuaj. E dimë se Kosova ka qenë shtet i centralizuar, në aspektin ekonomik dhe në rast se shkojmë nga decentralizimi, në aspektin ekonomik, duhet të plotësohet dhe të ndryshohet infrastruktura ligjore në tërësi. Gjatë përzgjedhjes së Bordit të KKK-së, edhe ne kemi hasur në vështirësi që i paraqet Ligji i konkurrencës. Mund të them se ndoshta ka qenë momenti i duhur, që ky Ligj, qysh atëherë të fillonte të ndryshohej. Në lidhje me Raportin, mund t'ju përgëzoj. Kërkoj nga ju që të veproni në bazë të Ligjit të konkurrencës, pra t'i respektoni procedurat e konkurrencës së lirë të tregut, për të cilat edhe neni 119 i Kushtetutës thotë se Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, për lirinë e aktiviteteve ekonomike dhe për sigurinë e pronës publike dhe private. Ju si Komision, në të ardhmen, gjatë draftimit të ligjit të ri, propozoni që ky Komision të shndërrohet në Agjenci shumë më të fortë. Duke marrë parasysh kërkesën se shteti i ri i Kosovës duhet të përballet me konkurrencën e lirë, një ndër faktorët e parë për zhvillimin ekonomik të saj është konkurrenca. Le të shihet edhe tek policat kufitare se kur Kosova do të jetë në Unionin e Kartanit Jeshil, edhe pse kjo varet nga numri i njohjeve. Për kompanitë e sigurimeve kjo paraqet problem. Në rast se duam të kemi ekonomi të lirë të tregut, së pari duhet të miratohet ligji i bankave dhe ligji i sigurimeve. Çështja e kamatave bankare, gjithashtu duhet të jetë e rregulluar me ligj dhe t'i përfshijë edhe çështjet e sektorit të telekomunikacionit, të sektorit të energjisë dhe të bizneseve të tjera. Unë jam për miratimin e Raportit tuaj. Besoj se në të ardhmen do të keni edhe ekspertë, mbështetës, që ky organ në të ardhmen të quhet Agjencia Kosovare e Konkurrencës, të jetë ngjashëm me agjencitë në rajon dhe të keni kompetenca

të mëdha që të mos lejoni monopol në shtetin e ri të Kosovës.

Komisioni e nxori këtë

Përfundim

I - Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit Kosovar të Konkurrencës nr. 03/3390/Ra - 06 të datës 24 mars 2010, për vitin 2009, dhe;

II - I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës ta mbështesë dhe ta miratojë Raportin vjetor të punës për vitin 2009 të Komisionit Kosovar të Konkurrencës nr. 03/3390/Ra - 06 të datës 24 mars 2010.

4. Miratimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për miniera e minerale

Sala Berisha Shala – kryesuese e grupit punës - Propozoi që Raportit të 30. 03. 2010 t'i bashkëngjiten edhe disa amendamente që kishin të bënin me nenet: 10.11; 24.9,10; 34.6,7; 77.3,4,5,6,7; 78 dhe me nenin 79 të Projektligjit që u miratuan.

Sala Berisha-Shala - Propozoi që të rishikohet mundësia e riamendamentimit të Institutit të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, me të cilin propozim Komisioni nuk u pajtua.

Përfundim

Komisioni e miratoi Raportin me gjithsej 74 amendamente për Projektligjin për miniera e minerale dhe e autorizoi njësinë mbështetëse të Komisionit që Raportin t'ua procedojë komisioneve kryesore.

5. Të ndryshme:

Komisioni u pajtua që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Raporti i Aviacionit Civil.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani